

VENDIM
Nr. 611, datë 24.7.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.590, DATË 5.9.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR CAKTIMIN E BANESAVE TË PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE TË
VENDIT, TË SELIVE, REZIDENCAVE DHE OBJEKTEVE TË TJERA SHTETËRORE, QË DO
TË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d” të nenit 4 të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën “a” të pikës 1 të vendimit nr. 590, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave, pas emërimit “... - Ministrit të Brendshëm...” shtohet “...- drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha